



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I ARKITEKTURËS

AREALI I POGRAGJËS

KONCEPTI PËR ZHVILLIMIN DHE PROMOVIMIN
E PEIZAZHIT KULTUROR



PROJEKT HULUMTUES



UNIVESITETI I PRISHINËS
FAKULTETI I ARKITEKTURËS

AREALI I POGRAGJËS

KONCEPTI PËR ZHVILLIMIN DHE
PROMOVIMIN E PEIZAZHIT KULTUROR

Prishtinë
2023

Fakulteti i Aritëkturës ©2023

Hartues të projektit hulumtues
sipas vendimit Ref.Nr. 3699/1 dt. 04.11.2022

Prof. Asst. Dr. Dukagjin Hasimja
Prof. Asoc. Dr. Florina Jerliu
Prof. Asst. Dr. Ardita Byçi Jakupi
Prof. Asoc. Dr. Vlora Navakazi
Prof. Dr. Arta Basha Jakupi
Asst. Dr. Arta Januzi Cana

Recenzioni:
Prof. Asoc. Dr. Teuta Jashari Kajtazi
Prof. Asst. Dr. Arta Xhambazi

Redaktor përgjegjës:
Prof. Dr. Violeta Nushi

Postproduksioni:
Prof. Asoc. Dr. Florina Jerliu

Përmbajtja

Parathënie	vii
1 POGRAGJA. AREAL KULTUROR DHE NATYROR.....	1
2 VIZIONI.....	5
2.1 TREKËNDËSHI REKRETUES TURISTIK KULTUROR DHE MJEDISOR	5
2.2 FAZAT ZHVILLIMORE.....	8
3 KONCEPTI ZHVILLIMOR	11
3.1 POGRAGJA – POZITA GJEOGRAFIKE.....	11
3.2 DISPOZITAT E PLANIT ZHVILLIMOR	12
3.3 KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË ZONËS.....	14
3.4 QASJA DHE LËVIZJET NË AREAL: TRAFIKU AKTIV DHE PASIV	15
3.5 KONCEPTI I ZONIMIT FUNKSIONAL - UDHËT	17
UDHA HISTORIKE	19
UDHA ORGANIKE	19
UDHA REKREUESE	19
UDHA E SPORTIT	20
“HUB” KULTUROR - SHESHI.....	20
3.6 ORGANIZIMI HAPËSINOR - TËRËSITË DHE SEKTORËT.....	20
PARTIA HYRËSE: “PORTA” E AREALIT	26
SHESHI QENDROR	27
LIQENI I POGRAGJËS	28
4 ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS BAZË	31
4.1 SHTIGJET / RRUGËT DHE GJELBËRIM	31
4.2 MOBILIARI MIKROURBAN	37
4.3 INFRASTRUKTURA TEKNIKE	43
4.4 NDËRTIMET.....	44
5 IMPLEMENTIMI	46
5.1 PRONËSIA DHE FORMAT E IMPLEMENTIMIT	46
5.2 AKTIVITETET.....	49
5.3 PLANET PËR IMPLEMENTIM	49

6	ZHVILLIMI I INTEGRUAR.....	53
7	SHTOJCA	55
7.1	AKTIVITETET POTENCIALE NË FUSHËN E TURIZMIT, IDENTIFIKUAR NGA ANA E KOMUNËS SË GJILANIT	55
7.2	LISTA KONTROLLUESE E KËRKESAVE TË BANORËVE	55
7.3	VIZUALIZIME (PRELIMINARE, PËR QËLLIME TË MUNDËSIMIT TË TË KUPTUARIT TË HAPËSIRËS	57
	Referencat.....	60

Parathënie

Projekti hulumtues *Zhvillimin dhe promovimin e peizazhit kulturor* - *Areali i Pogragjës* është zhvilluar mbi bazën e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar midis Komunës së Gjilanit dhe Fakultetit të Arkitekturës (FA), Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me nr. 144/01, dt. 03.02.2022, me objektivin parësor që të bashkëpunohet në hartim të projekteve zhvillimore në Komunën e Gjilant përmes mbështetjes dhe inkuadrimit të ekspertizës akademike dhe profesionale që ofron Fakulteti i Arkitekturës i Universitetit të Prishtinës “ Hasan Prishtina”.

Me Vendimin e dekanes së Fakultetit të Arkitekturës, Prof. Dr. Violeta Nushi, të datës 04.11.2022, Ref.Nr. 3699/1, është formuar grupi hulumtues i përbërë nga mësimdhënësit: Prof. Asst. Dr. Dukagjin Hasimja, Prof. Asoc. Dr. Florina Jerliu, Prof. Asst. Dr. Ardita Byci Jakupi, Prof. Asoc. Dr. Vlora Navakazi, Prof. Dr. Arta Basha Jakupi dhe Asst. Dr. Arta Januzi Cana.

Grupi hulumtues ka zhvilluar takime, konsultime dhe punëtori të përbashkëta dhe të vazhdueshme me zyrtarë të Komunës së Gjilanit dhe të institucioneve relevante si Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore e Gjilanit, banorë të Pogragjës dhe përfaqësues të sektorit privat që zhvillojnë aktivitete në zonë (Fig.1).

Projekti është përmbyllur në fund të vitit 2023 dhe i është dorëzuar Komunës së Gjilanit për konsiderim.




Fig. 1 Pamje nga punëtorja në Komunën e Gjilanit

Koncepti hulumtues është zhvilluar mbi bazën e studimit të zonës në shqyrtim dhe të analizës përmbajtësore të dokumenteve planifikuese zhvillimore të Komunës së Gjilanit, kornizës ligjore të Republikës së Kosovës si dhe mbi bazën e hulumtimit të kërkesave dhe nevojave të parashtruara nga qytetarët e Pogradjës, duke marr formë në sajë të ekspertizës së grupit hulumtues të Fakultetit të Arkitekturës.

Në funksion të përmbushjes së vizionit të dakorduar nga palët e marrëveshjes së bashkëpunimit, ky projekt, i emërtuar *Areali i Pogradjës - Koncepti për zhvillimin dhe promovimin e peizazhit kulturor*, propozon dy faza themelore zhvillimore:

Faza 1. Planifikimi dhe zhvillimi i zonës së ngushtë të arealit të Kalasë së Pogradjës dhe ndërlidhja e saj me fshatin e Pogradjës - që është subjekt i koncept-idesë të parashtruar në këtë dokument dhe

Faza 2. Planifikimi, definimi gjeografik dhe mbrojtja ligjore e arealit të Pogradjës si Peizazh Kulturor - për të cilën ky dokument ofron kahje zhvillimore potenciale.

1 POGRAGJA

AREAL KULTUROR DHE NATYROR

Pogragja shtrihet në juglindje të Gjilanit, në anën e djathtë të lumit Morava e Binçes, rrëzë Maleve të Karadakut. Është një vendbanim dardan i datuar që nga antikiteti dhe i identifikueshëm sot në saje të kalasë e cila ndodhet në perëndim të fshatit. Mendohet se atëbotë, kalaja ka qenë një qendër administrative, ekonomike dhe ushtarake e zonës përreth, nga ku është administruar edhe veprimtaria e minierës së hekurit dikur të ndodhur në kodrën përballë kalasë, në anën lindore të saj (Kadriu, 2008).

Kalaja e Pogragjës (Fig.2), monument i mbrojtur (Nr. E.K.251/56) përbën një aset të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Që prej pasluftës së vitit 1998-99, janë realizuar projekte të ndryshme në funksion të ruajtjes, konservimit dhe promovimit të saj. Një kronologji e ndërmarrjeve në këtë lokalitet është përshkruar në botimin e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore të Gjilanit, me autor Sh. Kadriu, “Kalaja e Pogragjës” (2008). Ka pasur ndërhyrjet restauruese të vazhdueshme që janë zhvilluar në kala. Në vitet 2007-2008 punimet janë zhvilluar në kuadër të projektit “Trajtimit të bimësisë dhe të ndërhyrjeve konsoliduese me qëllim të shpëtimit të monumentit – Kalaja e Pogragjës” që, siç thuhet - me qëllimin përfundimtar që kalaja të rikthehet në një magnet për turizmin kulturor në Anamoravë. Në vazhdimësi, Komuna dhe QRTK e Gjilanit me përkrahje të

institucioneve relevante, kanë vepruar në drejtim të realizimit të këtij vizioni (Kadriu, 2008).



Fig. 2 Kalaja e Pogragjës

(burimi: <http://pogragja.iliria-marketing.com/>)

Hapësira rrëzë kalasë shfrytëzohet mjaft nga banorët e Gjilanit dhe fshatrave përreth për piknik dhe aktivitete të ndryshme, duke dëshmuar kështu për potencialin që ka areali për zhvillim të turizmit kulturor dhe mjedisor. Ky aspekt zhvillimor i zonës ka bërë që qytetarët dhe banorët e zonës të argumentojnë për kërkesat dhe nevojat për zhvillim të planifikuar dhe të integruar të arealit, gjë që do të hapte rrugë për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit kulturor dhe mjedisor të zonës.

Rreth një kilometër larg në lindje të kalasë shtrihet vetë fshati Pogragjë (Fig.3). Siç konstatohet në me të drejtë: “lidhshmëria kala-fshat në kontekstin mjedisor e historik është e paevitueshme” (Kadriu, 2008). Sot fshati Pogragjë është qendër e bashkësisë lokale për zonën e fshatrave përreth (Llocë, Kokaj, Sllubicë, Stublinë), gjë që në njëfarë mënyre flet për pozicionin qendror që ka për arealin e gjerë të fshatrave të

zonës përreth. Është një fshat që veçohet për aktivizmin qytetar të mbështetur nga shoqata “Pogragja“ nga Zvicra, e cila kujdeset për mirëmbajtjen mjedisore të fshatit.



Fig. 3. Fshati Pogragjë
(Burimi: <http://Pogragja.iliria-marketing.Com/>)

Nisur nga këto attribute të afërsisë dhe kontinuitetit gjeografik dhe historik, Pogragja si fshat bashkë me kalanë e Pogragjës, përkufizohen me këtë koncept si peizazh urban historik i arealit të Pogragjës, me potenciale të shumta të zhvillimit të integruar (Fig.4).



Fig. 4. Pamje të peizazhit dhe arkitekturës së fshatit Pogragjë dhe zonës së arealit
Fotografi të shkrepura nga grupi hulumtues gjatë vizitave në terren, 2022-23

2 VIZIONI

2.1 TREKËNDËSHI REKRETUES TURISTIK KULTUROR DHE MJEDISOR

Pozita e rëndësishme ndërkufitare e rajonit të Anamoravës, e përfshin natyrshëm Pogragjën në një zonë strategjike të zhvillimit potencial ndërkufitar. Ky potencial është identifikuar edhe mbi bazën e shtresimit historik të rrjetëzimit të kështjellave në Kosovë, e veçanërisht të anës lindore të saj.

Historikisht, që nga antikiteti, falë pozitës së volitshme gjeografike, Pogragja ishte përshkuar në rrjetin rrugor që lidhte Ulpianën me qendrat tjera të rëndësishme të kohës nga Nishi e deri në Selanik. (Kadriu, 2008). Vlerësimi i këtij aspekti trashëgimor në të sotmen e vë kalanë e Pogragjës në mesin e trekëndëshit kombëtar të identifikuar si zonë me interes turistik (trekëndëshi i verdhë) ndërsa fshatin Pogragjë e identifikon si qendër të turizmit dhe trashëgimisë (Fig.5). Gjithashtu, rajoni i Gjilanit bën pjesë në trekëndëshin strategjik të zhvillimit ndërkufitar Gjilan-Bujanoc-Kumanovë, gjë që do të mundësonte zhvillimin e integruar ekonomik, kulturor e social të trevave të banuara me shqiptarë të këtij rajoni më të gjerë (Fig.6).



Fig. 5. Pogragja në trekëndëshin kombëtar - zonë me interes turistik:
Magjistrala e kështjellave të Kosovës juglindore, Monografia e Gjilanit, 2013. Burimi:
https://sq.wikipedia.org/wiki/Skeda:Kosova_juglindore.1193x1135.jpg




Fig. 6 Trekëndëshi ndërkufitar Gjilan-Bujanoc-Kumanovë. *Burimi:*
http://www.seecities.eu/Portals/0/Images/Stories/Publications/SSCE%20Brochure_WEB_Full%20version.pdf?ver=2021-01-22-002718-203

Marrë shkas nga çfarë u tha më lartë, propozohet që zona e ngushtë e Pogragjës të zhvillohet në funksion të përmbushjes së dy vizioneve, të nivelit kombëtar dhe atij ndërkufitar:

(a) Si zonë gravituese e arealit të Pogragjës - zonë me interes kombëtar të turizmit kulturor dhe rekreues;

Koncepti i zhvillimit të arealit të Pogragjës është në frymë me konceptin e ‘Peisazhit Kulturor’ sipas definicionit të UNESCO-s (2009). Ajo që mbetet për ta shndërruar këtë vizion në projekt të zbatueshëm është definimi dhe hartëzimi i territorit përbrenda suazave të trekëndëshit të identifikuar, kontekstualizimi i politikave dhe mjeteve bazuar në definicionin të UNESCO-s mbi peizazhin kulturor dhe konform legjislacionit vendor (MKRS, 2022).

(b) Si zonë ndërlidhëse e trekëndëshit rajonal (ndërkufitar) të Anamoravës me potencial të zhvillimit të integruar dhe me theks në zhvillimin e turizmit kulturor dhe mjedisor;

Koncepti i zhvillimit të rajonit ndërkufitar të Gjilanit merr shkas nga koncepti evropian për zhvillim të turizmit kulturor makro-rajonat” (KE, 2020), që sugjeron konceptimin e Udhëve Kulturore me qëllim rritjen e atraktivitetit të destinacioneve të largëta. Më konkretisht, inkurajimi i projekteve ndërkufitare me fokus trashëgiminë kulturore dhe natyrore është në linjë me angazhimet e BE-së (EPICAH InterregEurope).

2.2 FAZAT ZHVILLIMORE

Në funksion të përmbushjes së këtij vizioni të konsoliduar, janë propozuar fazat zhvillimore si në vijim:

Faza 1. Planifikimi dhe zhvillimi i zonës së ngushtë të arealit të Kalasë së Pogradit dhe ndërlidhja e saj me fshatin e Pogradit. Siç konstatohet tashmë, “lidhshmëria Kala – fshat në kontekstin mjedisor e historik është e paevitueshme” (Kadriu, 2008). Së këndejmi, kjo fazë përfshinë veprimet në vijim:

- (a) Planifikimi dhe zhvillimi i zonës së ngushtë të kalasë, në sipërfaqe prej rreth 3,9 Ha, me qëllim të promovimit të aktiviteteve rekreative kulturore dhe mjedisore,
- (b) Lidhja e zonës me fshatin Pogradit, me qëllim të promovimit të fshatit si qendër të turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
- (c) Planifikimi i trasesë së shtegut ekzistues që lidh zonën (a) me fshatin Stanaj (Stançiq) në kufi me Maqedoninë Veriore, shteg ky që aktualisht shfrytëzohet për “hajking” dhe i cili mund të bëhet nxitës i projekteve të mëtejme ndërkufitare.

Faza 2. Planifikimi, definimi gjeografik dhe mbrojtja ligjore e arealit të Pogradit si Peizazh Kulturor:

- (a) Përcaktimi i kufirit formal të arealit të Pogradit dhe mbrojtja ligjore e kësaj zone si Peizazh kulturor, që përfshin edhe planin/projektin për konservim/promovim arkeo-turistik të Kalasë si aset i trashëgimisë kulturore;
- (b) Zhvillimi i planeve dhe projekteve tematike në funksion të promovimit dhe zhvillimit kulturor dhe mjedisor të arealit, si dhe projekteve të tjera ndërkufitare përmes fondeve vendore, rajonale apo të tjera si IPA, etj.

FAZA 1:

PLANIFIKIMI DHE
ZHVILLIMI I ZONËS SË
NGUSHTË TË AREALIT
TË KALASË SË
POGRAGJËS DHE
NDËRLIDHJA E SAJ ME
FSHATIN E POGRAGJËS



3 KONCEPTI ZHVILLIMOR

3.1 POGRAGJA – POZITA GJEOGRAFIKE

Koncepti zhvillimor merr shkas nga vlerat e shumta të trashëgimisë kulturore që i atribuohen arealit, përkatësisht, vlera historike e Kalasë së Pogradjës, vlera mjedisore/natyrore e zonës si tërësi, vlera sociale e krijuar ndër vite në sajë të aktiviteteve shoqërore që zhvillohen aty, si dhe vlera ekonomike me potencial të rritjes së mëtejme pas intervenimeve zhvillimore të propozuara me këtë projekt.



Fig. 7 Kalaja e Pogradjës në hartën e Kosovës. Gjendet në zonën kadastrale Pogradjë, në parcelën me numër 01977-0




Fig. 8. Harta topografike Pogragjë (burimi: arkivi i FA-së)

3.2 DISPOZITAT E PLANIT ZHVILLIMOR

Koncepti i propozuar zhvillimor mbështet dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal të Gjilanit. Sipas ekstraktit të hartës më poshtë (Fig.9), Pogragja si fshat përcaktohet si qendër turistike, ndërsa zona e interesit që konceptohet me këtë propozim përcaktohet si hapësirë që përfshinë (shih legjendën poshtë): monumentin kulturor/natyror, respektivisht e identifikon kalanë, hapësirë për rekreim dhe shëtitje dhe restorantin.

Disa nga këto dispozita relevante për propozim konceptin, janë dhënë më poshtë (PZHK Gjilan, f.106):

- Nën pikën “Kushtet për rregullimin e zonave dhe tërësive me vlerë të veçantë” plani ordonon që Komuna e Gjilanit mund të bëjë hartimin e planeve hapësinore për zona të veçanta, specifikisht, për:
 - “Rezervuarin e liqenit dhe qendrën rekreative e Pogragjës”;

- Nën pikën “Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike”, më specifikisht për zonën e interesit:
 - Jashtë zonës urbane, asnjë ndërtim nuk do të lejohet në brigjet e lumit dhe një distancë prej 50 m’ në të dy anët e lumit do të jetë e mbrojtur.
 - Ndërtimi i akomodimeve të vogla në fshatra ekzistuese do të lejohet, nëse respektohet mjedisi.
- Nën pikën “Masat për zbatimin e planit”, më specifikisht për zonën e interesit:
 - Plani Rregullues urban i fshatit Pogragjës




Fig. 9. Ekstrakt nga harta e Planit Zhvillimor të Komunës së Gjilanit

3.3 KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË ZONËS

Areali gjendet në një zonë natyrore të pasur me vegjetacion të lartë kryesisht drunjë gjetherënës. Përbëhet prej disa tërësive karakteristike të cilat dallojnë mes veti për nga funksioni si dhe karakteristikat topografike:

- Hapësira e rrafshët në të hyrë të lokacionit paraqet hapësirën potenciale për zhvillim, respektivisht, përbën zonën e ndarë në tre sektorë intervenimi, ku ndodhet edhe vija ujore bashkë me liqenin akumulues;
- Zona e kalasë, një kodër me tokë pyjore, e dendur me drunjë në anën veriore të saj ndërsa në anën jugore më e rrallë dhe e kombinuar më shkurre, si dhe në majë të saj lokaliteti gërmadhat e kalasë;
- Lumi Morava, i cili bashkë me degëzimin e tij krijon një liqen të vogël akumulues, si dhe
- Rruga për qasje bashkë me urën e zonës.




Fig. 10. Shfrytëzimi i tokës dhe pronësia

Pronësia në këtë zonë është e kombinuar. Pjesën më të madhe të sipërfaqeve, tokën pyjore bashkë me zonën e kalasë, e përfshinë toka në pronësi publike respektivisht Drejtoria e Pyjeve, ndërsa sipërfaqja e rrafshët, pjesë e intervenimit me këtë dokument, është në pronësi të komunës. Disa rripa toke përgjatë breglumis si dhe përgjatë rrugës janë pronë private (Fig.10).

3.4 QASJA DHE LËVIZJET NË AREAL: TRAFIKU AKTIV DHE PASIV

Qasja

Qasja në areal bëhet nga rruga kryesore Gjilan-Pogragjë. Rruga është e asfaltuar dhe shërben për trafik aktiv (Fig.11), ndërsa ka potencial të bollshëm për të përfshirë shtegun çiklist dhe këmbësorik. Propozohet që këto shtigje alternative, pra shtegu i çiklistëve dhe i këmbësorëve, të realizohen përgjatë gjithë rrugës që lidh qytetin e Gjilanit dhe fshatin Pogragjë, bashkë me 2-3 stacione të autobusit, që do të mundësonin promovimin e qasjes në areal përmes linjës së dedikuar të autobusit “Gjilan - Kala-Pogragjë” .




Fig. 11. Qasja në zonën e arealit

Qasja në zonën e brendshme të nënkalasë së Pogragjës e cila aktualisht është e frekuentuar dhe prandaj është subjekt planifikimi me këtë propozim, bëhet përmes urës e cila më pastaj shtrihet në pjesën e rrafshët të lokacionit. Aktualisht, ura ka gjerësi rreth 4 m dhe akomodon një korsi për automjete me trotuar në të dy anët.

Propozimi parasheh përmirësimin e qasjes dhe zgjerimin e urës duke e respektuar standardin për gjerësi minimale të rrugës 6.0 m. Kjo është e rëndësishme sidomos nëse merret në konsideratë koha e pikut të zonës në të cilën ka frekuencë më të lartë. Profili i propozuar i rrugës/urës është gjithsej 10.0 m përfshirë shtigjet për këmbësorë në të dy anët e saj (2.0m+6.0m+2.0m) (Fig.12). Rëndësia e shtigjeve në të dy anët lidhet me shpërndarjen e njerëzve drejt qëllimit të tyre: aktiviteteve në natyrë, ato kulturore apo formale në sheshin e arealit.

Qasja e promovuar në areal përkrah konceptin e trafikut pasiv. Koncepti e vë këmbësorin në qendër të vëmendjes. Ura cilësohet si “portë hyrëse”, prej nga vizitorët orientohen drejt shtigjeve dhe hapësirave të propozuara në brendi të zonës.



Fig. 12. Ilustrim i zgjerimit të urës
duke krijuar dy shtigje/trotuare me gjerësi min. 2m,
si ura anësore në të dy anët e urës ekzistuese

Vendparkimi

Qasja për automjete propozohet që të kufizohet vetëm përgjatë një linjeje. Me të hyrë në pjesën e rrafshët në anën perëndimore përgjatë bregut të lumit, propozohet që të bëhet shtrirja e parkingut me 50 vendparkingje, prej të cilave 2 janë për persona me aftësi të kufizuara. Vendosja e parkingut në këtë zonë lidhet me aspektin e ndarjes së qartë në mes të lëvizjes së automjeteve dhe këmbësorëve, duke tentuar që të këtë sa më pak lëvizje të veturave të në areal. Gjithashtu, edhe morfologjia e terrenit është determinuese në këtë drejtim: është synuar që të shfrytëzohet pjesa e rrafshët e terrenit ndërkohë që të zbatohet kushti i intervenimit minimal në natyrë, si dhe natyrisht edhe kostoja e realizimit të parkingut.

Propozohet mundësia e qasjes për automjete në brendi të zonës vetëm për qëllime mirëmbajtje dhe furnizimi (furnizimi organizohet sipas orareve të caktuara nga komuna).

3.5 KONCEPTI I ZONIMIT FUNKSIONAL - UDHËT

Koncepti i propozuar në përgjithësi artikulon kërkesat e komunitet dhe të Komunës së Gjilanit. Propozimi bën ndarjen funksionale të zonës përmes konceptit të “udhëve” tematike. Udhët përkrahin aktivitetet ekzistuese dhe të tjera të parapara në areal. Ato marrin në konsideratë atributet historike të lidhura me kalanë, atributet natyrore organike, kapacitetin rekreues dhe sportiv të zonës si dhe formon nyjen e bashkimit të udhëve në një shesh të përbashkët (Fig.13):

- Udhë historike
- Udhë organike
- Udhë rekreuese
- Udhë e sportit, si dhe
- “Hub” kulturor - sheshi




Fig. 13. Koncepti zonal – UDHËT

UDHA HISTORIKE

Udha historike ndjek shtegun aktual që çon sipër kodrës deri tek Kalaja e Pogragjës. Është quajtur historike për faktin se si e tillë është e vjetër. Kjo udhë përmbledhë të gjitha atributet dhe aktivitetet që rrëfejnë historinë dhe vlerat e trashëgimisë kulturore të Pogragjës. Udha është e gjatë rreth 1000 m. Përveç njohjes me Kalanë në mënyrë kognitive, vizitorët mund të mësojnë më shumë edhe përmes përcjelljes nga ana e ciceronëve ose përmes audio-mjeteve me rrëfime të regjistruara që mund të sigurohen në info-point. Përgjatë kësaj udhe, propozohen 6 pika të vëzhgimit (soditëse), si intervenim minimal dhe reversibil brenda zonës së Kalasë, që do të montohen në afërsi të vendndodhjes së rrënojave të zonës së Kalasë historike. Koncepti i intervenimit minimal /reversibil mundëson montimin/ demontimin e këtyre elementeve mikro-urbane në raste të përnjohjes/hulumtimit të mëtejme arkeologjik të zonës së kalasë.

UDHA ORGANIKE

Udha organike ndjekë të ashtuquajturën “rrugë e Kalasë” e cila ndjekë rrjedhën e lumit Morava dhe çon deri në fshatin Pogragjë. Është quajtur organike meqë lidhja e ngushtë e kalasë me fshatin është historike dhe e natyrshme njëkohësisht. Kjo udhë sipas konceptit zhvillimor, mundëson që vizitorët të qëndrojnë në areal jo vetëm gjatë orëve të ditës, por edhe më gjatë. Udha i dedikohet vetëm këmbësorëve, që njëkohësisht e promovon ecjen rekreative prej kalasë e deri në fshat, si alternativë e shëndoshë kundrejt lëvizjes me automobil. Promovimi i ushqimit vendor, bujtinave dhe veprimtarive komplementare rekreuese sportive dhe kulturore në fshat, e bën arealin e Pogragjës me potencial të destinacionit turistik. Vetë udha i destinohet ecjes rekreuese.

UDHA REKREUESE

Udha rekreuese ndjek shtegun e “hajkingut” respektivisht, ecjes në distancë të gjatë, që nisë nga këtu e vazhdon tej drejt fshatit Stanaj (Stançiq) që ndodhet në kufi me Maqedoninë Veriore. Propozimi mbështetet në shfrytëzueshmërinë tashmë të dëshmuar të këtij shtegu. Kjo udhë ka potencialin të tërheqë individë dhe grupe të organizuara ecjeje, nga vendi, rajoni dhe më gjerë, të cilët së fundmi kanë zgjedhur këtë mënyrë të rekreacionit aktiv në natyrë. Në këtë fazë të parë, mendohet që të përpunohet shtegu natyral në gjatësi prej 2,5 km. Brenda këtij segmenti fillestar, do të sigurohen shenjëzimet /informata përmes tabelave informuese për udhën e gjatë të hajkingut deri dhe përtej fshatit Stanaj, së bashku me ndalesat e pushimit në distanca të caktuara përgjatë shtegut, ndërhyrje këto që mund të bëhen nxitës të

projekteve të ardhshme potenciale, siç parashihet me këtë propozim në kuadër të fazës së dytë.

UDHA E SPORTIT

Udha e sportit është një linjë e re e propozuar si zgjatim i linjës “zip-line”- një sport i ri atraktiv që është funksional në areal. Udha aktuale që çon në zip-line shtrihet në anën e djathtë të partisë hyrëse, paralel me udhën organike, ndërsa zgjatimi mendohet të bëhet në të majtë të partisë hyrëse, përgjatë rrjedhës së lumit Morava. Gjatë këtij shtegu, po ashtu i dedikuar për këmbësorë, mendohet që në një fazë të dytë, të hulumtohen potencialet për zhvillim të fushëlojave në të hapur bashkë me infrastrukturë përcjellëse, si dhe një qendër sportive. Në fazën e parë, propozohet që ky shteg të krijohet në gjatësi prej 1 km si shteg vrapimi (jogging). Gjithashtu, në përmbushje të kërkesave të qytetarëve, përgjatë shtegut gjatë fazës 1, mund të improvizohen fushat e basketbollit “Street ball” (disa sosh).

“HUB” KULTUROR - SHESHI

Ndërlidhja e udhëve në kuptimin hapësinor bëhet përmes sheshit kryesor që zë vendin qendror në terrenin e rrafshët rrëzë kalasë. Aktualisht, kjo sipërfaqe e madhe në të hapur shfrytëzohet për tubime dhe aktivitete të ndryshme në natyrë nga qytetarët e komunës dhe më gjerë. Propozohet që ky atribut i qendrës të mbahet dhe që zona të formësohet ashtu që të fitojë konotacionin e mirëfilltë si “hub kulturor” – pra, është pika grumbulluese prej nga bëhet shpërndarja e vizitorëve nëpër udhët tematike.

3.6 ORGANIZIMI HAPËSINOR - TËRËSITË DHE SEKTORËT

Organizmi hapësinor i arealit është bërë përmes duke e ndarë zonën në tërësi dhe sektorë (Fig.14).

- **Tërësia 1** përbën pjesën e rrafshit, respektivisht fazën e parë të intervenimit i cili është i ndarë në 3 sektorë: partia hyrëse apo “Porta e arealit”; sheshi qendror dhe liqeni i Pogragjës,
- **Tërësia 2** përbën zonën e lokalitetit të kalasë,

- **Tërësia 3** përbën zonën e hajkingut që shtrihet në kontekst më të gjerë gjeografik, pra kodra me tokë pyjore e cila lidhjet edhe me zip-line dhe mëtutje, më fshatin Pogragjë. Për këtë tërësi ofrohet koncepti zhvillimor dhe hyn në planet afatgjatë të Komunës.



Fig. 14. Tërësitë dhe sektorët e Arealit

Tërësia 1 dhe 2 përbëjnë Fazën 1 të intervenimeve në Areal.

Faza 1 parashih ndërhyrje minimale në lokalitet, të cilat do të mundësonin hapjen formale dhe të organizuar të zonës së Pogradit për vizitorët. Sipas kërkesave të paraqitura nga komuniteti si dhe kërkesave që dalin nga ky koncept zhvillimor, faza e parë duhet të plotësojë kërkesat nominale për qëndrim të këndshëm të vizitorëve në lokalitet. Po ashtu, ndërhyrja minimale si qasje dhe filozofi e zhvillimit të projekteve peizazhore, i mundëson zonës të prezantojë plane më afatgjata dhe të qëndrueshme, dhe së këndejmi, edhe propozime tekniko-investuese që do të përkraheshin nga institucionet vendore dhe të tjera ndërkombëtare. Parashihet që kjo fazë të implementohet brenda periudhës: mesi i vitit 2023- mesi i vitit 2025.




Fig. 15. Diagrami i organizimit hapësinor

Zona e ngushtë që është subjekt i implementimit të fazës 1, përbëhet prej tri sektorëve funksional (Fig. 16, 17 dhe 18):

- [1] Partia hyrëse apo "Porta e arealit"
- [2] Sheshi qendror
- [3] Liqeni i Pogragjës



Fig. 16. Sektorët funksional – propozimi inicial




Fig. 17. Sektorët funksional sipas konceptit të propozuar



Fig. 18. Propozimi konceptual i sektorëve

PARTIA HYRËSE: “PORTA” E AREALIT

Partia hyrëse përfshinë zonën e komunikimit dhe qasjen në lokacion dhe shërben si pikë grumbullimi/shpërndarjeje nëpër udhët tematike. Këtu bën pjesë qasja në parking dhe qasja në sheshin qendror, dhe është konceptuar si “Porta” hyrëse e arealit (Fig.19).




Figura 19. Partia hyrëse: “porta” e arealit- propozim

Intervenimet në partinë hyrëse përfshijnë:

1. Zgjerimin e urës ekzistuese
2. Krijimin e stacionit/ndalesës së autobusit (linja Gjilan-Pogradje)
3. Pastrimin/regjenerimin e brigjeve të lumit Morava (segmenti funksional i arealit me gjatësi sa të parkingut), si fazë e parë e pastrimit/regjenerimit të lumit në tërësi, sipas planeve dhe parashikimeve të Komunës së Gjilanit;
4. Krijimin e parkingut me vendparkingje në dy anët, me 50 vende parkimi. Në respektim të kushteve të PZHK lidhur me distancën 50 m nga lumi, propozohet që parkingu të materializohet sipas konceptit natyror, me intervenim

minimal të dyshemesë (rrafshim i terrenit, shtresë zhavorri);

5. Ndërtesën e Portës, që akomodon info deskun me zyra të menaxhimit, hapësirat për shitjen e suvenireve, tualetet dhe zhveshtoret, biletarinë dhe caktimin e termineve për aktivitetet (sport, koncert, teatër, etj.) që do të zhvillohen në sheshin qendror. Në respektim të kushteve të PZHK lidhur me distancën 50 m nga lumi, struktura propozohet të jetë ndërtim montazh.
6. Laura dhe gardhi vendosen në pikat e nevojshme, nëse komuna e Gjilanit e koncepton kompleksin dhe menaxhimin e tij sipas koncept të mbyllur.

SHESHI QENDROR

Sheshi qendror paraqet hapësirën kryesore shumëfunktionale përmes të cilit bëhet orientimi nëpër udhët tematike, respektivisht, shpërndarja nëpër zonat e caktuara (Fig. 20). Në pjesën perëndimore dhe lindore është definuar përmes amfiteatrit natyror, ndërsa në pjesën veriore definohet përmes ndërtesës së Portës. Forma e sheshit lidhet me morfologjinë e lokacionit. Ai është vendosur në pjesën e rrafshët ndërsa në vendin e tangjentimit me kodrën e kalasë fillon amfiteatri. Sheshi është dimensionuar duke u bazuar në varietetet e aktiviteteve që mund të zhvillohen aty si: sportive, kulturore, argëtuese, edukative etj.




Fig. 20. "Hub" Kulturor - Sheshi qendror - propozim

Krijimi i sheshit qendror përfshin intervenimet si në vijim:

1. Rregullimi/pllakëzimi i platosë së sheshit, që përfshinë edhe vendosjen e linjave që definojnë fushat e sportit.
2. Krijimi i piacetës së vogël në pikën ku fillon udha historike (ngjitja për kala) ku ndodhet tabela informuese dhe këndi i uljes.
3. Krijimi i shkallarëve të amfiteatrit sipas konceptit të përpunimit të peizazhit në mënyrë natyrore (formësim i dheut i shtruar me dërrasa). Të dy kodrat të cilat e definojnë hapësirën e lirë janë shfrytëzuar për të krijuar shkallarë për ulje.
4. Rregullimi i vijës ujore, përroit, si element estetik i sheshit. Këtu hyn:
 - a. përpunimi natyror i brigjeve të jazit – përroskës,
 - b. ndërtimi i një ure montuese këmbësorike për kapërcimin e përroskës në pikën që lidh hapësirën e portës me udhën organike.

LIQENI I POGRAGJËS

“Liqeni i Pogragjës” bën pjesë në “Rezervuarin e liqenit dhe qendrën rekreative e Pogragjës”, siç përcaktohet me PZHK të Gjilanit. Aktualisht, liqeni akumulues është i krijuar në mënyrë joformale përmes një pende që ka mundësuar grumbullimin e ujit të lumit Morava, si dhe shfrytëzohet nga vizitorët.

Duhet theksuar se lumi paraqet një nga kualitetet e arealit i cili përmes llojllojshmërisë së vegjetacionit dhe topografisë së ndryshueshme e definon zonën e arealit. Pjesë e rëndësishme është degëzimi i tij i cili ndonëse me sasi të vogël të ujit, është i rrjedhshëm dhe ka dëshmuar kapacitet të mjaftueshëm të akumulimit të një liqeni për rekreim. Kjo rrjedhë ujore paraqet gjithashtu element formësimi dhe një tipar estetik të sheshit në përgjithësi.

Si fazë e parë e implementimin, propozohet që Liqeni i Pogragjës të zhvillohet në atë mënyrë që të mbahet komponenti natyror i tij dhe njëkohësisht, të modernizohet aktiviteti i larjes rekreative duke e inkorporuar edhe pishinën në të hapur. Pishina e

hapur konceptohet si dy-komponentëshe: a) sipërfaqja e pishinës e definuar si pishinë gjysmë-olimpike, ku mund mbahen kurse dhe gara të notit, b) sipërfaqja pishinës e definuar si pishinë rrethore dedikuar si pishinë rekreuese (Fig.21). Propozohet që pishina të shfrytëzohet edhe gjatë sezonit të dimrit si pistë patinazhi.

Inkorporimi i pishinës justifikohet me kërkesën standarde të modernizimit të hapësirës larëse. Kështu, vizitorët mund të përzgjedhin që të lahen në pishinë më komfore (psh. fëmijët dhe të tjerët që preferojnë këtë mënyrë) ose në liqenin akumulues natyror.




Fig. 21. Liqeni i Pogragjës – propozim

Krijimi i Liqenit të Pogragjës përfshin intervenimet si në vijim:

1. Rregullimi i shtratit të liqenit aktual akumulues, që ruan formën ekzistuese. Varësisht nga përzgjedhja, rregullimi mund të jetë ashtu që shtrati të mbetet natyror, apo të përpunohet me shtresat përkatëse standarde (si p.sh. liqeni i Gërmisë në Prishtinë);
2. Krijimi i pendës dhe rezervuarit akumulues për menaxhimin dhe sigurimin e ujit të mjaftueshëm për liqenin akumulues dhe për pishinën;
3. Krijimi i pishinës me sipërfaqe 630 m² buzë liqenit, me teknologji përkatëse dhe sipas standardeve për këto objekte, që ka kapacitet për të akomoduar notin

dhe lojërat në ujë. Këtu të parashihet edhe opsioni i ngrirjes së dyshemesë së pishinës me mekanizma përkatës për shfrytëzimin e saj si pistë patinazhi.

4. Rregullimi / pllakëzimi minimal i sipërfaqeve të parapara për vendosje të hapësirave për rrezitje (shezllonë dhe çadra) si dhe hapësirave për ulje. Në pjesën perëndimore të liqenit, për shkak të pjerrësisë së terrenit do të punohet peizazhi me kaskada duke tentuar që kjo hapësirë e rekreimit të duket sa më e natyrshme.
5. Në zonën e liqenit bën pjesë kafeneja dhe restoranti, hapësira për inventar (shezllonë, çadra, ulëse, etj., si ndërtim montazh dhe me infrastrukturën përcjellëse).
6. Ura e furnizimit, që mundëson qasjen automobilistike për në kafene/ restorant, për qëllime të furnizimit.

4 ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS BAZË

4.1 SHTIGJET / RRUGËT DHE GJELBËRIM

Në këtë fazë parashihet realizimi i shtigjeve për automjete dhe këmbësorë. Trasea e shtigjeve e projektuar në këtë fazë mbetet trase afatgjate, por me mundësi reverzibiliteti, ndërkohë që realizimi/ekzekutimi i shtigjeve është maksimalisht natyral; materialet për realizim të shtigjeve janë natyrore dhe ekonomike:

- **Rruga automobilistike (200 m²)** - dhe sipërfaqja e parkimit për autobusë dhe automjete, do të shtrohen me zhavorr me ngjyrë të hirtë;
- **Vendparkingjet (1350 m²)** - shtrohen me zhavorr me ngjyrë të hirtë, ose mund të definohen me blloqe betoni me fuga për vegjetacion;
- **“Hub” kulturor - Sheshi (2550 m²)** - sipërfaqe e pllakëzuar;
- **Pikëtakimet (“meeting points”) (3 sipërfaqe me diametër 5m)** –një vendoset në afërsi të stacionit të autobusit, një tjetër menjëherë pas kapërcimit të lumit Morava, në hyrje të Arealit, dhe një në Piacetën e udhës

historike (Fig.24). Formohen si mozaqe sipas dizajneve të caktuara, që mund të përfshijnë motive nga trashëgimia historike/kulturore e Gjilanit (Fig.25).

- **Platoja e restorantit (950 m²)** - sipërfaqe e pllakëzuar;
- **Shtigjet e këmbësorëve** - përpunohen mundësisht me ngjyra të ndryshme (Fig.22) për të diferencuar karakterin e udhëve dhe linjave të ndryshme të trafikut pasiv:
 - Udhë historike (3000 m²) – shtrohet me zhavorr ngjyrë okër;
 - Udhë organike (3000 m²) - përpunohet duke e ngjeshur dheun (rrafshohen, presohen dhe mirëmbahet shtresa e dheut ose/dhe vegjetacioni), ose shtrohet zhavorri bardhë;
 - Udhë rekreuese (3000 m²) - shtrohet me zhavorr ngjyrë të hirtë/kaltër;
 - Udhë e sportit (3000 m²) - shtrohet me zhavorr ngjyrë të kuqe;
 - Shtigjet e liqenit (1000 m²) – janë trase që shënjohen copa shiritore tartani;
 - Shtigjet ekstreme - ku në projekt janë të definuara pikat hyrëse në shteg;
 - Ura druri të lustruar (2 copë) do të realizohen në vende ku parashihet kalimi mbi rrjedhë ujore (Fig.26).



Fig. 22. Shembull i zhavorrit me ngjyrë për shtigje/rrugë




Fig. 23. Diagrami i shtigjeve/rrugëve




Fig. 24. Diagrami i pikëtakimeve



Fig. 25. Shembuj të pikëtakimeve të formuara si mozaik



Fig. 26. Shembuj të urave të vogla
ura për këmbësorë kalimi i lumit dhe pengesave të terrenit përgjatë shtigjeve, si dhe ura për furnizim me automjet te restoranti

Gjelbërimi – mirëmbahet gjelbërimi ekzistues dhe në disa vende, sipas dizajnit mbillen dy lloje të vegjetacionit, i lartë, i mesëm dhe i ulët (Fig.27).

Në bazë të rolit dhe funksionit të tij, gjelbërimi është ndarë në :

- **Gjelbërim izolues (50 copë)** - ka për qëllim mbrojtjen nga ndotja dhe zhurma. Është i vendosur kryesisht përgjatë rrugëve dhe parkingut me qëllim të izolimit edhe vizuel. Llojet e propozuara: *tilia cordata* (10 copë), *tilia tomentosa* (10 copë) dhe *acer campestre* (30 copë).
- **Gjelbërim dekorues (30 copë)** - ka për qëllim definimin e hapësirës së sheshit duke ia dhënë komponentën dekorative brezit që e kufizon anën lindore të sheshit qendror. Lloji e propozuar: *prunus cerasifera* – që përmes ngjyrës së saj krijon lojë dhe kontribuon në llojlojshëminë e nuancave.
- **Gjelbrim potencues (5 copë)** – ka për qëllim potencimin e hapësirave përmes vertikalitetit apo estetikisht duke dhënë varicione ngjyrash. Propozohet: *taxus baccata* (3 copë) dhe *picea conica* (2 copë), të vendosen pranë pikave të takimit, ndihmojnë drejtimin/orientimin e vizitorin në pikën e caktuar.
- **Gjelbrim interpolues (30 copë / 50 rrënjë)** - ka për qëllim plotësimin e tërësive të caktuara në dy kodrat natyrore përmes variacioneve të drunjtëve përfshirë edhe drunjët halor si: *picea conica* dhe *pinus silvestre*. Këtu hyjnë edhe shkurret e dendura si: *junieris*, *buxus sempervirens*.



Fig. 27. Llojet e propozuara të drunjve

- **Shkallarët e gjelbërt (750 m²)** – në vende të caktuara me dizajn parashihet kaskadimi natyror i terrenit për të formuar shkallarë/tribuna natyrore,
- **Sipërfaqe e barit (1200 m²)** – ku sipas dizajnit lejohet kalimi/qëndrimi dhe sipërfaqet e barit dekorativ që nuk shkelet; si dhe me shkurre të ‘gjalla’ si gardhe kufizuese të hapësirave për rrezitje (Fig.28).



Fig. 28. Shembuj të përpunimit natyror të brigjeve të rrjedhave lumore
(majtas: para dhe pas regjenerimit; djathas, përpunimi në segmentet / rastet e nevojshme dhe kaskadimi i terrenit për të formuar shkallarë)

4.2 MOBILIARI MIKROURBAN

Tabelat e informimit - Janë paraparë dy lloje të tabelave informuese/ shenjëzimit:

- Tabela të mëdha informative, 3 copë (me dimensione 120 x 90 cm) të cilat ofrojnë informata të përgjithshme (plani, oraret, etj), një të ndërtesës dhe portës, afër urës, një të hapësirës së restorantit dhe një në fshatin Pogragjë.

- Tabela të Mesme tematike, 6 copë (me dimensione 70 x 50 cm). Secila ofron informata më të hollësishme për konceptin dhe mënyrën e shfrytëzimit/aktiviteteve: katër tabela për katër udhët (udha historike, organike, rekreuese, e sportit), një tabelë për sheshin qendror dhe një tabelë për liqenin. Një set i tabelave tematike, po ashtu në bus-stop (Fig.29).
- Tabela e Vogël (me dimensione aktuale) – mbahet tabela ekzistuese (ose modifikohet sipas dizajnit) që tregon drejtimet për në lokalitetet historike (Ulpianë, etj....).




Fig. 29. Shembuj të tabelave informuese dhe tematike

Bankat për ulje bashkë me shporta të hedhurinave - do të vendosen në pika të caktuara sipas dizajnit, kudo që parashihen pika të pushimit në lokacion si dhe përgjatë udhëve tematike. Aty ku është e mundur dhe nuk ka hije natyrale, pranë bankave për ulje mund të vendosen pergolat nga druri ose pëlhura. Këto mund të vendosen edhe në vend të çadrave për rrezitje në zonën e liqenit (Fig.30).



Figura 30. Shembuj të bankave, shportave dhe pergolave/çadrave

Pikat e soditjes— nga të gjitha udhët, udha historike ka një kualitet shtesë meqë ofron mundësi për soditje të panoramës së arealit nga lartësitë e kodrës së Kalasë së Pogragjës. Propozohet që në bashkëpunim me MKRS, IAK, përgjatë shtegut historik të organizohen në formë të intervenimit reversibil gjashtë (6) pika soditëse/pika pushuese, në formë të terracave që dalin pak si konzolë. Këto pika soditëse propozohet që të vendosen në afërsi të gërmadhave të identitifuara si të dukshme në sipërfaqe, siç paraqitet në skicën (Fig.31). Gjithashtu, evitimi i pjerrtësive të mëdha

në vende të caktuara përgjatë shtegut për në kala, mund të bëhet përmes përmes aplikimit të pjerrinës së shkallëzuar si në (Fig 32).




Fig. 31. Pikat e soditjes – propozim



Fig. 32. Shembull i pikës së soditjes

majtas: shembull i intervenimit minimal (propozohet si qasje në fazën 1); djathas dhe poshtë: shembull i intervenimit me arkitekturë atraktive (propozohet që një nga pikat e soditjes (ose më shumë) të projektohet në këtë frymë gjatë fazës 2

Një propozim si zgjidhje optimale e intervenimit minimal dhe reversibil, është dhënë (Fig.33). Propozimi parasheh shtangimin me dërrasa të konsolës tarracë duke përfshirë edhe një segment të udhës. Kjo pushimore, e dhënë në dy variante, ofron pikë-qetësim për vizitorët, të cilët nga këtu vrotojnë peizazhin natyror por kanë edhe mundësi të vrojtimit të gjërmadhëve sipërfaqësore. Pikat përfshijnë vende për ulje dhe qëndrim në këmbë dhe mund të përfshijnë edhe teleskopë. Gjithashtu, këto pika mundësojnë kushtimisht kushte më të mira për arkeologët gjatë punës së tyre në

studim/konservim të segmenteve përkatëse të gjërmadhve të identifikuara. Pikat e vrojtimit validohen së bashku me MKRS/IAK.




Fig. 33. Propozim për pikat soditëse

Për të eliminuar pjerrësitë e mëdha në shtegun e kalasë, propozohet që sipas një projekti më të detajuar, eliminimi i pjerrësive të mëdha të bëhet duke kombinuar pjerrësinë me kapërcim- hapi, i cili mund të realizohet me trarë druri të vendosur horizontalisht me shteg. Shembulli në foto (fig. 34) paraqet konceptin e propozuar (kapërcimi-hapi ulet ndjeshëm për t'u përshtatur me pjerrësinë).



Figura 34. Shembull i eliminimit të pjerrinave të vështira përgjatë shtegut për në kala

Maketa e Arealit me toponime burimore – Areali i Pogragjës ka pika kodrinore dhe hapësira tjera, me toponime të lashta, që ende mbahen mend nga të vjetrit. Propozohet që të krijohet lista e toponimeve burimore dhe të hartëzohet, me qëllim të formimit të një makete nga materiali i qëndrueshëm, që do të vendosej në piacetën prej nga nisë udha kulturore. Përmes saj, vizitorët do të familjarizohen edhe me këtë komponentë kulturore të arealit. Maketa ka edhe funksion të përnjohjes taktile për persona të verbër, duke u mundësuar atyre që të kuptojnë shtrirjen hapësinore të zonës që kanë zgjedhur ta vizitojnë. Shembuj të maketave topografike janë paraqitur në figurën e mëposhtme (Fig.35)



Figura 35. Shembull i maketave/modeleve topografike

4.3 INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Furnizimi me energji elektrike - për ndërtesat, si dhe për ndriçim të jashtëm do të përcaktohet me projektin e inxhinierisë elektrike. Koncepti parasheh që në parim, furnizimi me energji elektrike për nevoja të ndërtesave të sigurohet nëpërmjet rrjetit, ndërsa ndriçimi i jashtëm, përkatësisht, shtigjet dhe pikë-pushimet, mund të realizohet me anë të trupave ndriçues të cilët e shfrytëzojnë energjinë diellore. Kjo alternativë, përveç faktit që promovon konceptin bashkëkohor të efijencës së energjisë, e shmang problemin e ndërtimit të nënstacioneve dhe të shtrirjes së kablllove të furnizimit me energji elektrike nëpër lokalitet dhe përgjatë udhëve tematike (Fig.36).

Instalimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit- për nevojat e ndërtesave montazhe, përkatësisht, ndërtesës së portës dhe restorantit, si dhe për nevoja të Liqenit / pishinës, do të përcaktohen me projektin e inxhinierisë hidroteknike.



Fig. 36. Shembuj të ndriçimit solar

4.4 NDËRTIMET

Bazuar në aktivitetet e arealit janë planifikuar dy ndërtesa të cilat lidhen me kërkesat bazike në raport me funksionimin e tij, si dhe disa punkte ndërtimesh montazh/lëvizëse për nevoja të pishinës. Ndërtesat duhet të jenë nga elemente çmontuese si dhe nga materiale të cilat janë natyrore dhe të ripërdorshme. Forma dhe ngjyrat duhet t'i përshtaten kontekstit. Për shkak të pranisë së vegetacionit të lartë në dy kodrat e arealit, kujdes duhet t'i kushtohet sigurisë nga zjarri, e që duhet të jetë në përputhshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Pyjet e Kosovës si dhe udhëzimin administrativ për mbrojtjen e pyjeve.

Ndërtesa kryesore (rreth 220 m²) - e cila gjendet me të hyrë në areal në të cilën gjendet zyra informuese, biletaria, toaletet dhe zhveshtoret, shitore për suvenire, dhe hapësira teknike dhe e depove. Është propozuar një gabarit i mundshëm për ndërtesën (Fig. 37).



Figura 37. Gabariti idhe përmbajtja e ndërtesës së portës - propozim

Restoranti (rreth 350 m²) - i cili gjenden në pikëprerje të liqenit dhe sheshit qendror, qka ka një terracë në të hapur si dhe pjesë e së cilit është dhe një depo e inventarit (çadrave / shezllonëve etj). Është propozuar një gabarit i mundshëm për ndërtesën (Fig.38), ndërsa organizimi funksional dhe arkitektura mbeten subjekt i një konkursi arkitektural.



Fig. 38. Gabariti dhe përmbajtja e ndërtesës së restorantit me terracë - propozim

Punktet e pishinës: zhveshtoret, dushat, çezmet–parashihet që të vendosen në 3-4 pika në afërsi të pishinës. Janë propozuar alternativat e organizimit të këtyre punkteve, si dhe pozicionimi i tyre në lokacion (Fig.39).



Fig. 39. Shembull i punktut të pishinës

5 IMPLEMENTIMI

5.1 PRONËSIA DHE FORMAT E IMPLEMENTIMIT

Pronësia e zonës së projekt propozimit implikon parcela me pronësi të ndryshme. Pjesa e trajtuar në kuadër të fazës së parë si dhe hartëzimi i territorit përbrenda trekëndëshit të identifikuar në këtë zonë, indikojnë parcela në pronësi të Komunës së Gjilanit, Drejtorisë së Pyjeve si dhe prona private, rregullimi i të cilave sipas këtij projekt propozimi duhet të shqyrtohet sipas mundësive të implementimit që mund të ofrojnë marrëveshjet e Partneriteteve Publiko Private (PPP).

Kalaja e Pogragjës e cila gjendet në zonën kadastrale Pogragjë, në parcelën me numër 01977-0, me sipërfaqe të parces prej 1206338 m², sikur dhe territoret përreth, parcelat me numër 1964-0 (sip. 35091 m²), 1962-0 (sip. 6578 m²), 1963-0 (sip. 6578 m²) që të gjitha janë në pronësi të “P.SH. Drejtorisë së Pyjeve” (Komuna e Gjilanit, 2022).




Fig. 40. Pronësia e zones së projektpropozimit
(Burimi: Komuna e Gjilanit)

Nga dispozita e pronësisë në hartën Fig.40 sugjerohet që:

Spektori 1 – Partia Hyrëse “Porta e Pogragjës” – të zhvillohet në partneritet me një entitet formal që përfaqëson pronarët e tokave private, e që mund të jetë “SHOQATA POGRAGJA”. Partneriteti (PPP) do të përcaktonte kushtet e bashkëfinancimit (psh. Komuna e Gjilanit 100%) dhe bashkë-menaxhimit (sipas një raporti përkatës të përqindjes).

- Fushëlojat (streetball) mund të zhvillohet si biznes privat në pronat private përgjatë “Udhës së Sportit”. Taksa apo subvencionimi i saj mund të përfshihet në klauzolat e PPP,
- Shtegu që e definon “Udhën e Sportit” përpunohet (shtrohet me zhavorr) me investime komunale ndërs amirëmbajtja/menaxhimi mund të përfshihet në klauzolat e PPP.

Spektori 2 - Sheshi qendror - shtrihet në parcelën me nr. 1963-0 në pronësi të Drejtorisë së Pyjeve si dhe në parcelën me nr. 4398-0 në pronësi të komunës së Gjilanit

- Disa nga aktivitetet e dhëna më poshtë mund të përfshihen në klauzolat e PPP, të tjerat mbeten subjekt i vendimmarrjes së Komunës së Gjilanit,
- Mirëmbajtja/ menaxhimi dhe format e shfrytëzimit të fushëlojave (volejboli) mund të përfshihen në klauzolat e PPP.

Spektori 3 – Liqeni i Pogragjës- shtrihet në parcelën me nr. 4398-0 e cila është në pronësi të Komunës së Gjilanit. Kjo hapësirë është shfrytëzuar dhe menaxhuar deri tani në mënyrë joformale nga entitet private. Me qëllim rregullarizimit e kësaj hapësire bashkë me aktivitetin aktual, sugjerohet realizimi dhe menaxhimi i Liqenit të bëhet nga ana e Komunës së Gjilanit, me mundësi të hapjes së shprehjes së interesit për persona juridik për mirëmbajtjen dhe menaxhim e zonës së Liqenit. Një kontratë potenciale do të rregullonte

- Mirëmbajtjen dhe menaxhimin e pishinës bashkë infrastrukturën përcjellëse
- Mirëmbajtjen dhe menaxhimin e hapësirave të përcaktuara për rrezitje
- Ndërtimin dhe menaxhimin e restaurantit

5.2 AKTIVITETET

Aktivitetet në zonën e konceptit të propozuar mund të përfshijnë disa nga aktivitetet vjetore/jubilare që organizohen nga Komuna e Gjilanit si:

- Vrapim për ditën e çlirimit të Gjilanit - Qershor Qyteti i Gjilanit - mund të përfshijë edhe shtegun këmbësorik deri në areal
- Ditët e diasporës - Korrik- Gusht – jashtëzakonisht e përshtatshme që të organizohen në areal
- Ngjarje të tjera kulturore që aktualisht organizohen në Gjilan e që do të mund të organizoheshin në areal, sidomos gjatë stinëve të ngrohta.

5.3 PLANET PËR IMPLEMENTIM

Për implementim të suksesshëm të këtij projekti Komuna e Gjilanit harton:

1. Projektin zbatues për zonën e Arealit të Pogragjës të trajtuar në këtë koncept dokument, në sipërfaqe prej c. 3,9 hektarësh;
2. Organizon konkurse për: dizjanin e pikëtakimeve me mozaik (psh. për studentë të fakultetit të arteve), dizajnin për pikat soditëse, shtigjeve anësore të urës ekzistuese, për projektin e ndërtesës së arealit, për projektin i ndërtesës së restorantit.
3. Planet për mënyrat e shpronësimit dhe/ose përdorimit të parcelave të përfshira në këtë koncept dokument;
4. Planet e financimit /bashkë-financimit me institucionet relevante dhe/ose PPP;
5. Planin e menaxhimit të zonës;
6. Formon Bordin menaxhues
7. Formon Fondacionin Areali i Pogragjës
8. Planin për “soft skills” – Planin e Biznesit dhe Planin përcjellës për trajnimin e personave përgjegjës;
9. Planin e aktiviteteve ditore, stinore dhe vjetore, për tu publikuar për qytetarë.



FAZA 2:

ZHVILLIMI I
INTEGRUAR I AREALIT
TË POGRAGJËS ME
THEKS NË ZHVILLIMIN
E TURIZMIT
KULTUROR DHE
MJEDISOR

6 ZHVILLIMI I INTEGRUAR

Faza e Dytë kuptohet si fazë zhvillimore që mund të planifikohet gjatë një periudhe afatmesme investimi nga Komuna e Gjilanit në partneritet me pushtetin qendror ose/dhe komunat fqinje subjekt i projekteve të propozuara në këtë kapitull. Me këtë propozim, Faza e Dytë përkufizohet si zonë ndërlidhëse e trekëndëshit rajonal (ndërkufitar) të Anamoravës me potencial të zhvillimit të integruar dhe me theks në zhvillimin e turizmit kulturor dhe mjedisor.

Në kapitullin 2. Vizioni, ky koncept propozon planifikimin, definimin gjeografik dhe mbrojtjen ligjore të arealit të Pogragjës si Peizazh Kulturor.

Komuna e Gjilanit mund të angazhohet në planifikim të projekteve vijuese:

- Hartimi i Planit urban të Pogragjës, sipas PZHK, duke e definuar atë si fshat turistik (me theks në komponentën “bed-and-breakfast”),

Në bashkëpunim me MKRS dhe MMPH, Komuna e Gjilanit mund të angazhohet në planifikim të projekteve vijuese:

- Përcaktimi i kufirit formal të arealit të Pogradjës dhe mbrojtja ligjore e arealit si Peizazh Kulturor,

Fasilitim në hartim të planit/projektit për konservim/promovim arkeo-turistik të Kalasë së Pogradjës si aset i trashëgimisë kulturore të Kosovës, si dhe i planit të menaxhimit të integruar të arealit

- Zhvillimi i planeve dhe projekteve tematike në funksion të promovimit dhe zhvillimit kulturor dhe mjedisor të arealit. Këtu mund të përfshihen:
 - projekti për guidë të licencuar turistike,
 - udha kulturore e kështjellave të Kosovës lindore (shih Fig. 5)
 - Shtigjet e biçikletës malore në udhët antike (psh. që nisë nga tabela informuese ekzistuese dhe ndjek drejtimet e vendbanimeve antike)

Në bashkëpunim me Qeverinë dhe institucionet ndërkombëtare zhvillimore, Komuna e Gjilanit mund të angazhohet në planifikim të projekteve të tjera ndërkufitare përmes fondeve vendore, rajonale apo të tjera si IPA, etj.:

- Udhë e hajkingut Pogradjë-Stanaj (Stançiq) – Maqedoni Veriore (e tutje). Këtu mund të përfshihen pika kampingu dhe shenjëzimet e duhura
- Stanet e Anamoravës – si entitet i organizuar dhe me karakter promovues ekonomik -kulturor të trekëndëshit ndërkufitar Gjilan- Bujanoc-Kumanovë (shih Fig. 6).

7 SHTOJCA

7.1 AKTIVITETET POTENCIALE NË FUSHËN E TURIZMIT, IDENTIFIKUAR NGA ANA E KOMUNËS SË GJILANIT

Kërkesa	Adresimi
1. Krijimi i shtegut të Hikingut	✓
1.1. Shenjëzimet e Hikingut	✓
1.2. Pushimoret gjatë shtegut	✓
2. Bujtinat	Në fshatin Pogragjë
3. Kasolle për Barinjë	Si fazë e dytë e implementimit të Arealit
4. Soft Skills: Plani i Biznesit dhe Planin përcjellës për trajnimin e personave përgjegjës	✓
4.1. Hartimi i një Plan Biznesi	✓
4.2. Trajnimi i personave përgjegjës (sipas Planit të Biznesit).	✓

7.2 LISTA KONTROLLUESE E KËRKESAVE TË BANORËVE

Kërkesa	Adresimi
1.Parkingu-i cili do të shërbej për vizitorët e Kalasë	✓
2.Rregullimi i rrugës për në kala si dhe ndriçimi i saj	✓
3.Disa Teleskop (brenda hapësirës së Kalasë)	te pikat e vrojtimit (në shteg)
4.Fusha e Volejbollit (beach volley)	shenjëzohen të sheshi qendror
5.Fusha e Basketbollit me një tabelë (street ball).	improvizohen/projektohen përgjatë shtegut të sportit

6.Disa tavolina për Ping-pong (nga çimentoja)	shenjëzohen të sheshi qendror
7.Muri mbrojtës (në rast të vërsimeve të mos dëmtohen fushat)	pjesë e projektit zbatues në segmentet e arealit
8.Ulëse dhe tavolina	ulëse përgjatë shtigjeve, tavolina të te terasa e restorantit
9.Skara/grilla për pjekje	moblie
10.Çadra	✓
11.Tabela Informuese (një historik I shkurtër I Kalasë).	✓
12.Tezga	✗
13.Shporta dhe Kontinier për mbeturina	✓
14.Ndriçimi i hapësirës poshtë kalas	✓
15.Vendosja e kamerave në hyrje të kalasë	Sipas projektit
16.Veranda (pushimore të mbuluara)	✓
17.Urë e drurit (e cila shërben për të kaluar lumin)	✓
18.WC Publike	✓
19.Ndërtimi i një pishine të vogël me dim. 15m x15m	✓
20.Mbjellja e pemëve rreth lumit	✓
21.Mirëmbajtje në hapësirat e Kalasë si dhe poshtë Kalasë	Sipas implementimit
22.Pastrimi i Lumit Morava ne hyrjet e kalasë	✓
23.Shtigje për ecje rreth lumit si dhe shtigje në male	✓

7.3 VIZUALIZIME (PRELIMINARE, PËR QËLLIME TË MUNDËSIMIT TË TË KUPTUARIT TË HAPËSIRËS







Referencat

Kadriu, Sh. 2008, *Kalaja e Pogragjës*, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore Gjiilan

McHarg, I. (1969). *Design with Nature*. John Wiley & Sons.

Waldheim, C. (Ed.). (2006). *The Landscape Urbanism Reader*. Princeton Architectural Press.

Jokilehto, J. (1999). *A History of Architectural Conservation*. Butterworth-Heinemann.

MKRS, 2022. Rregullore nr. 11/2022 për inventarizimin dhe procesin e përzgjedhjes së trashëgimisë kulturore për mbrojtje

UNESCO, 2009. Nora Mitchell, Mechtild Rössler, Pierre-Marie Tricaud (Authors/Ed.). *World Heritage Cultural Landscapes. A Handbook for Conservation and Management*. World Heritage Papers 26. Në: <https://whc.unesco.org/en/series/26/>

Këshilli i Evropës (2020) *Cultural tourism in the EU macro-regions: Cultural Routs to increase attractiveness of remote destinations / Routes4U* | 7, në: <https://rm.coe.int/routes4u-manual-attractiveness-remote-destination-cultural-tourism/16809ef75a%0A%0A>

ICOMOS. (2008). *The ICOMOS Charter for the Interpretation and Presentation of Cultural Heritage Sites*.

EPICAH Interreg Europe: Effectiveness of Policy Instruments for Cross-Border Advancement in Heritage, në: <https://projects2014-2020.interregeurope.eu/epicah/>

Plani Zhvillimor Komunal i Gjiilanit, në: <https://gjiilani-komuna.org/mod=mod&id=85&mid=98>
<https://unhabitat-kosovo.org/ep-content/uploads/2019/08/Plani-Zhvillimor-Komunal-i-Gjiilanit-2006-2015.pdf>

Komuna e Gjiilanit. (2022). *Strategjia për Zhvillim të Qëndrueshëm*. <https://mzhr.rks-gov.net/desk/inc/media/04608A85-13D9-4EDC-BEFE-7AE67FC2B6BB.pdf>

Udhëzimi Administrativ Nr.08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor